



BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Datë 25.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje kamion mbi 7.5 ton

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Kamionë vetëshkarkues 34134200-7
- Kamionë pune 42415200-0

VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 4,570,000 (katër milionë e pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë PA TVSH

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vleres te parashikuar te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e references, sasite, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjes për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr 484 Prot.date 23.10.2024.

Ato janë si më poshte:

<i>I</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia
1.	Kamion mbi 7.5 ton	1 cope

Kamion mbi 7.5 ton

- Kamioni duhet të jetë me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe e gatshme për punë.
- Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha paisjet dhe aparaturat duhet të jenë funksionale dhe konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian.

- Gabina duhet të jetë konform rregullave të Bashkimit Europian, me sistem të ngrohjes dhe ftohjes Mjeti duhet te jete minimumi 1+1.
- Mos kete me shume se 300000km
- Kamioni duhet të jetë e tipit vetshkarkues me karroceri metalike
- Vinci te jete me hapje hidraulike
- Kamioni te jete jo me shume se 3 akse (ne rast se eshte me 2 akse te kete vinc, Vinci te kete kapacitet ngrites jo me pak se 3000 kg ne piken e tij me te afert ngritese.
- Konfigurimi i akseve duhet te jete 4 x 4
- Mjeti të jetë jo më i vjetër se viti 2000
- Motorri të jetë me naftë
- Vellimi i motorit te jete jo me i vogel 6300 ccm 3
- Motorri të jetë në gjendje të mirë dhe të mos ketë rrjedhje vaji.
- Pjesët hidraulike të jenë pa rrjedhje
- Kapaciteti mbajtes i karrocercise ne m3 duhet te jete jo me i vogel se 5 m3 dhe jo me i madh se 15 m3.
- Me thikë përpara me sistem hidraulik në të katërta pozicionet (lart, posht, majtas, djathtas) me komandim nga kabinat e drejtuesit të mjetit.
- Me depozitë të c'montueshme (montueshme) në karocerinë e kamionit për depozitim të kripës, së bashku me mekanizmin centrifugal për shpërndarjen e kripës në rrugë ku kapaciteti i depozites jo më i vogël se 5 m3.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mjeti duhet te jete i pajisur me dokumentat përkatëse sipas DPSHTRR (targa, taksa, siguracion, tahograf, kolaudim).

Në fondin limit përfshihen të gjitha veprimet dhe shpenzimet deri në kalimin e pronësisë së mjetit në emër të NSHP-së.

Specifikimet teknike të mjetit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për këtë mjet i cili do të ndihmojë Autoritetin Kontraktor në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT